



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:067773

Datë: 14.06.2022

Numri i dokumentit: 03130497

**P.nr.99/21**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK-** Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me praktikanten Edona Thaçi, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit, Nd.nr.29/22 të datës 12.05.2022 e lidhur në zyrën ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit N.L, nga Komuna Kaçanik dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës KEDS-Distrikti Ferizaj, i autorizuari B. S., e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.495/21 të datës 12.04.2021, për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, në bazë të nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, më datën 13.06.2022, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**PRANOHET** marrëveshja e ndërmjetësimit Nd.nr.29/22 të datës 12.05.2022 e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit të kësaj gjykate, në mes të pandehurit N.L dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës KEDS-Distrikti Ferizaj, B. S.

**HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.495/21 të datës 12.04.2021 dhe **PUSHON** procedura penale ndaj të pandehurit N.L, nga Komuna Kaçanik, i lindur me datë 16.08.1980 për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1, të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.495/21 të datës 12.04.2021, ka akuzuar të pandehurin N.L, nga Kaçaniku për shkak të veprës penale, Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1, të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 13.01.2022 , palët në procedurë janë pajtuar që lënda penale e evidentuar si P.nr.99/21, të procedohet sipas procedurës së ndërmjetësimit.

Gjykata duke vepruar konform, nenit 8 par.3 të Ligjit për Ndërmjetësim vendosi që çështja të dërgohet në Zyrën e Ndërmjetësimit.

Me datën 12.05.2022 në Zyrën Ndërmjetësimit te kësaj gjykate, është arritur marrëveshja ndërmjetësimit , Nd.nr.29/22, në mes palëve në procedurë dhe ate të pandehurit N.L, nga Komuna Kaçanik, dhe përfaqësuesit të dëmtuarës KEDS-Distrikti Ferizaj, B. S..

Andaj, Gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim e aprovoi këtë Marrëveshje, pasi që të njëjtën e vlerësoi që është lidhur me vullnetin e palëve në procedurë dhe në pajtim me ligjin në fuqi.

Nga sa u tha më lartë e konform nenit 358 par. 1 të KPP-se lidhur me nenin 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr. 06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**P.nr.99/21 datë, 13.06.2022**

Praktikantja  
Edona Thaçi

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KESHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.